



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER SANJA A. TELHALLARI  
ADRESA Njesia Administrative Kashar,  
Yzberish, Bulevardi "Migjeni"  
TEL: +355672022444

## KRIJIMI I SHOQATAVE OSE AKTI I THEMELIMIT

Nr. repertori: 18796

Nr. koleksioni: 11540

Tirane më 16/09/2024

Ligjet referuese:

- Liqji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- Liqji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- Liqji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024052121253758114



A2024052121253758114

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA  
"NOV" SH.P.K**

Sot, më datë **16/05/2024** (dymije e njecete e kater), para meje Notere **SANJA A. TELHALLARI**, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Njësia Administrative Kashar, Yzberish, Bulevardi "Migjeni", u paraqit personallsh:

**THEMELUES/IT:**

**Dorjan Dogjani**, atësia Haxhi, amësia Mereme, shtetas Shqiptar, lindur në Osmanaj, Kukës dhe banues në TIRANË, me adresë E Kavajës; Nd. 209/1; H. 1; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiale Nr. 7; 1023; Tirane, lindur më 28/05/1989, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035351124 dhe nr. personal 190528081G.

Dorjan Dogjani me vuillnetin e tij të lire dhe të pote, te shprehur nëpërmjet këtij Akt Themelimi dhe Statuti, vendosi kriimin e shoqerisë me përgjegjësi te kufizuar "NOV" me kushtet e me poshtme.

Aktiviteti i saj do te regullohet nga Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi.

Administrator i shoqerise do te jete Dorjan Dogjani, asati dhe kompetencat percaktohen me poshtë ne statut.

Adresa e shoqerise do te jete Rruga E KAVAJËS; 21 Square Kompleks, Nd. 209/1; H. 1; ; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 7; NJËSIA BASHKIAKE NR. 7; 1023; TIRANË.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar

Neni 62, pika 1, gërrma "I" të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"

**KREU I**

**HYRJE**

**Neni 1**

Shoqeria me përgjegjësi të kuflzuara "NOV" sh.p.k është themeluar nga ortaku si me poshtë vijon:

I. Dorjan DOGJANI  
Themeluesi është madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në përputhje me ligjin "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" hartojnë edhe statutin e Shoqerisë si më poshtë:

**KREU II  
PERKUFIZIME**

**Neni 2**

Emertimi i shoqerisë është "NOV"

**Neni 3**

Asambleja e ortakëve ka vendosur miratimin e statutit të shoqerisë në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shoqerisë, vecanërisht sipas ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statute.

Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit në Qëndrën Kombetare të Regjistrimit. Ojithash tu shoqeria e bazon aktivitetin e saj në ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 "Per Mbrojtjen e Konkurencës" të ndryshuar, në Kodin Civil dhe Kodin e Punës si dhe në ligje të tjera në Republikën e Shqipërisë,

**Neni 4  
Forma**



Shoqëria "NOV" sh.p.k është "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar"



A2024052121253758114

**Neni 5**

**Selia**

1. Selia e Shoqërisë do të jetë Rruga E KAVAJËS; 21 Square Kompleks. Nd. 209/1; II. 1; ; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 7; NJËSIA BASHIKIAKE NR. 7; 1023; TIRANË.
2. Shoqëria ka të drejtë të hapi filial të tjera brënda territorit të Republikë së Shqipërisë në varësi të selisë qëndrore që ndodhet në rrethin e Tiranës.
3. Vend i mbajtjes së asamblesë së përgjithshme është selia e shoqërisë.
4. Nëse bihet dakt me unanimitet, mbledhja e asamblesë mund të kryhet në një vënd tjostër.

**Neni 6**  
**Objekti i Veprimtarisë së shoqërisë**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jëtë:

Import-eksport dhe shitje-blerje me shumice dhe pakice te vajrave lubrifikante si dhe te cdo lloji tipi te vajrave te tjera me perberje sintetike dhe lubrifikante qe perdoren aktualisht per lubrifikimin e cdo lloji autoveturë dhe automjeti.

Import-eksport dhe shitje me shumice dhe pakice te pjesave te kembimit, bateri, tapete gome, filtra, goma, adetiv, adblu, antifriz, graso dhe aksesore per autovetura dhe automjete te te gjitha llojeve dhe tipave te ndryshme duke perfshire ketu autovetura dhe makina te cdo lloji tonazhi, industri si dhe autorarje, luicidim, bojatiste dhe gomisteri e konvergjencë gomash per automjete. Import- Eksport i pajisjeve dhe produktive elektronike dhe tregtimin e tyre brenda dhe jashte vendit.

Tregtimi me shumicë të mallrave industriale, ushqimore, bujqësore, vegla pune, konfeksione, hidrosanitare, veshje pune, elektrike, inerte, materialë ndertimi. Import, tregtim bateri, tapete gome, filtra makineri bujqësore. Import dhe tregtim automjete. Tregti te produktive te ndryshme. Konsulencë mjedisore dhe marketingu. Realizim te reklamave te ndryshme. Tregti me shumice dhe pakice te produktive te kancelarise. Tregti me shumice dhe pakice te produktive te pastrimit, bojerave per printer, te tjera te ngashme.

Tregtia me shumicë e mobiljeve të zyrave, tregtia me pakicë e pjesëve elektronike, Tregtia me pakicë e karburantit për automjete. Shërbime ushqimi dhe pije. Restorante dhe shërbim ushqimor i lëvizshëm. Katering me porosi për raste dhe shërbime të tjera ushqimore.

Marrja pjesë ne tendera dhe unkande private dhe publike si dhe kryerrja e sherbimeve qe kane lidhje me objektin e veprimtarisë se saj. Magazinim i artikujve te ndryshem per shitje, përpunimin, prodhimin dhe tregtimin e gomës, plastikes dhe artikujve të tyre. Përpunimin, prodhimin dhe tregtimin e kimikateve dhe produktive te industries kimike.

Hapje Agjenci turistike, imobiliare, hapje dhe shrytezim motelesh, baresh restorantesh, diskotekash, lojra argetuese per familje, qender sportive, qendra pushimi e kurative. Tregtim bimesh medicinale e etero-vajore, plehrash e prodhimesh te tjere kimike. Tregtim prodhimesh kozmetike e estetike. Aktivitetet ne fushen e ndertimit, etj.

Krijimi i serviseve per automjete, servis per riparimin e autoveturave dhe automjeteve te te gjitha llojeve dhe tipeve te ndryshme tonazhi, lavazhe dhe hapja e agjensive turistike. Magazinim i produktive te ndryshme. Transport i mallrave dhe pasagjerave brenda dhe jashte vendit dhe aktiviteve mbështetëse për transportin Dhënia me qera dhe hua e mjeteve të transportit. Dhënia me qera dhe hua e kamionëve. Prodhim montim dhe shperndarja te materialeve dhe te elementeve te sinjalistikes dhe sigurise rrugore.

**Neni 7**  
**Vula e shoqërisë**





A202105212125375814

- Shoqëria ka vulen e saj, në brëndësi të së cilës shkruhet i plotë emërtimi dhe forma e saj juridike.
- Të gjitha aktet që dalin nga shoqëria, pasi nënshkruhen sipas ligjit, vulen me vulen e shoqërisë.

### Neni 8 Kohëzgjatja e Shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit me përfashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Pergjithshme.

### Neni 9 Veprimot e lejuara të shoqërisë

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, selinë, kohëzgjatjen dhe objektin e veprimitarise së saj sipas vendimeve që do të marrë asambleja e Përgjithshme me shumicen e ortakeve që përfaqësojnë të paktën % e pjesëve të kapitalit.

### Neni 10 Marredhenia e punës

- Shoqëria për të kryer veprimitarinë e saj sipas objektit të këtij statute do të lidhë kontrata individuale për të rregulluar marredheniet e punës.
- Kontratat e punës do të lidhen konform ligjt "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë" dhe dispozitive të tjera ligjore që rregullojnë marredheniet e punës në Republikën e Shqipërisë.

## KREU III

### PARIMI I DETYRIMIT TË BESNIKËRISË

#### Neni 11 Ndalimi, konflikti I interest dhe personat e lidhur

- Personi i autorizuar për të përfaqësuar ose mbikqyrur shoqerinë tregtare nuk mund të lidhë kontratu apo të hyje në marredhenie të tjera me shoqerinë tregtare, nëse nuk deltarohen kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interest të tij e veprimi nuk autorizohet paraprakisht prej të gjithë ortakeve ose të gjithë ortakëve të tjera.
- Cdo miratim paraprak dhe i përgjithshëm njostohet për regjistrim në Qëndrën Kombëtarë të Regjistrimit.
- Miratimi I parashikuar jepet, gjithashu, për cdo kontratë apo marrëdhënie tjetër, që shoqëria lidh me palë të treatë, e cila ka marredhënie personale apo financiare me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikqyrur shoqérine, apo me palë të tjera, marrëdhëni e të cilave me personat e mësipër janë të lidhur që, në mënyrë të arsyeshme, mund të ndikojnë vendimmarrjen e tyre në kundershtim me interest e shoqërisë. Personat në vijim prezumohen të kenë një apo më shumë nga interest e mësipërm me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikqyrur shoqerinë:
  - a) bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit, vëllezërit ose motra e bashkëshortit/bashkëshortes;
  - b) fëmijët, prindërit, vëllezërit, motrat, fëmijët e fëmijëve ose bashkëshorti/bashkëshortja e personave të mësipërm;
  - c) personat e lidhur me personelin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikqyrur shoqerinë, Personat të lidhur janë: të paralindurit ose të paslindurit, të afërmit në vijë të tërthortë të shkallës së dytë, birësuesi ose i birësuari, I afërmë I shkallës së parë i bashkëshortit/bashkëshortes;
  - d) një person, që banon me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikqyrur shoqerinë.
- Personat, të cilët kërkojnë miratim për një transaksion, sipas pikave 2 e 3 të këtij nenit, nuk mund të marrin pjesë në votimin për miratimin e veprimit e nuk llogariten në kuorume.
- Cdo veprim që kërkon miratim, sipas pikës 2 dhe 3 të këtij nenit, publikohet në pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimitarise, së bashku me kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interest të personave të përfshirë.
- Për efekt të këtij statute, me persona të autorizuara për të përfaqësuar ose mbikqyrur shoqerinë tregtare do të kuptojmë ortakët e shoqërise, administratorin, ekspertin kontabël të autorizuar dhe likuiduesin e shoqërisë.



A2024052121253758114

**Neni 12**  
**Parimi i Besnikërisë**

1. Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interest e shoqërisë dhe të ortakëve të tjérë. I njëjtë detyrim zbatohet edhe për administratorët.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjose nga ky satut, në rrethana të tjera, ortakët gjëzojnë të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë.

**Neni 13**  
**Ndalimi i Konkurencës**

1. Personat e autorizuar për të përsfuqësuar ose mbikqyrur shoqerinë tregtare mund mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqeri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektorë ekonomik me shoqërinë e pure.
2. Ndalimi i përmendur në pikën 1 të këtij nenit shfuqizuar nëpërmjet një autorizimi të posacem, të dhënë nga ortakët nga asambleja e përgjithshme me shumicë të kualifikuar.
3. Ndalimi i përmendur në pikën 1 të këtij nenit, ëmbetur në fuqi edhe pas humbjes së cilësisë apo statutit të përmendur në të, për një periudhë një vit pas humbjes së kësaj cilësie.
4. Nëse ndonjëri prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij nenit shkel ndalimin e konkurencës, shoqëria mund:
  - a) ta përsashtoje atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
  - b) të kërkojë ndërprerje të veprimtarisë konkureuese;
  - c) të ngrejë paqil për shpërbllimin e dëmit.
5. Shoqëria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërbllimin e dëmit, mund t'i kërkojë secilit prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij nenit:
  - a) të pranojë se transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
  - b) t'i transferojë shoqërisë të gjitha përsitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të trëtë;
  - c) t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.
6. Padia për ushtrimin e të drejtave të shoqërisë ngritet brënda tre viteve nga data e kryerjes së shkeljes. Për ngritjen e padisë ndaj personave të sipërpërmëndur zbatohen, gjithashu, dispozitat e pikës 3 të nenit 10 të ligjit "Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare".

**Kreu IV**

**KAPITALI THEMALTAR – PJESMARRJA**

1. Kapitali i shoqërise ka vlerën 100.000 Leke (njëqind mijë leke) e cila perfason 1(nje) kuote.
2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
3. Në rast zmadhimi të kapitalit nëpërmjet shtimit të kuotave të reja, ortakët kanë të drejtën e përpërsisë së nënshtirim, proporcionalisht me shumën e kuotave të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.
4. Kapitali i shoqërisë, mund të zgogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
5. Zvogëlimi i kapitalit i prekë të gjithë ortakët në të njëjtën masë ndaj kuotave të kapitalit që ata përsaqësojnë. Kapitali nuk mund të zgogëlohet nën kusirin minimal që lejon ligji "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare".

**Neni 15**  
**Kontributet**

Kapitali i shoqërisë do të jetë 100.000 Leke(njëqind mijë), zotërohet nga ortaket e e shoqërisë:

- Dorjan Dogani zotëron 100 % te kuotave me vlerë 100.000Leke (njëqind mijë leke).

Vlera e kapitalit themaltar të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakëve sipas raportit të paraqitur më sipër.

**Neni 16**  
**Kalimi i kuotave të kapitalit**



A2024052121253758114

1. Kuotat e kapitalit tē shoqërisë janë tē kalueshme ndërmjet ortakëve dhe tē kalueshme në rrugë trashëgimie. Trashegimtari paraardhësi ose pasardhësi, bëken ortakë, nëpërmjet kalimit të kuotave tē kapitalit.
2. Kuotat e kapitalit tē shoqërisë mund tu kalohen personave tē tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, me vendimë tē marrë me shumicën e ortakëve që përsaqësojnë tē paktën  $\frac{1}{2}$  e pjesëve tē kapitalit.
3. Në rast kur njëri apo disa nga ortakët dëshirojnë tē kalojnë pjesërisht apo plotësisht, kuotat që ata zoterojnë në kapitalin e shoqërisë tek tē tretët, më parë duhet që oferta për shitje tu behet ortakeve tē tjerë tē shoqërisë. Kur ortakët që gjëzojnë tē drejtët e parablerjes kanë dyshime rreth emimit të kuotave tē ortakut që kërkon ti kaloj ato, mund ti drejtohet gjykatës që tē caktoj një ekspert vlerësues. Ortaku që kërkon kalimin e kuotave te tē tretët duhet te lajmërohet në një asfat sa më tē shpejtë, nëse brenda 4 javëve ortakut nuk l'jepet një përgjigje atëherë prezumohet se ortakët e tjerë kanë rën dakort që kuotat e tij mund ti kalojnë tē tretëve.
4. Kalimi I kuotave do tē bëhet me kontratë.
5. Kuotat mund tē pjesëtohen për shkak tē kalimit tē tyre.

#### Neni 17

1. Ortakët mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer tē kontributiveve tē nënshkruara.
2. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar tē shoqërisë me përgjegjësi tē kufizuar.

#### KREU V ORGANET E SHOQËRISE, KUORUMI DHE ZGJEDHJA E TYRE

#### Neni 18 Asambleja e Përgjithshme

1. Cdo ortak ka tē drejtë tē marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë së Përgjithshme, dhe disponon një numër votash tē barabarë me kuotat e kapitalit që ai zoteron.
2. Ortaku mond tē përsaqësitet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë tē një autorizimi nga bashkëshortja ose një person tjeter i zgjedhur prej tij, me kusht që këta tē jenë autorizuar me procure.
3. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertët kontabël tē autorizuari, po qe se ka tē tille, nga likujduesit apo ortakët , tē cilët përsaqësojnë tē paktën 5 % tē totalit tē votive në Asamblenë e përgjithshme tē shoqërisë. Këta ortakë mund ti drejtojnë administratorëve një kërkcesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për tē thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe/ose përfshirjen e cështjeve tē posacme në rendin e ditës. Kërkesa duhet tē përmbajë arsyet, objektivat dhe cështjet, për tē cilat asambleja duhet tē marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortake kane tē drejtë ta thërrasin Asamblenë e Përgjithshme dhe tē caktojnë cështjen e rendit tē ditës. Njoftimi do tē bëhet me shkresë ose nëpërmjet pastës elektronike.
4. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet tē përmbaje vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditëse t'u dergohet tē gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
5. Nëse në kundërshtim me piskën 5 tē këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, osc cështja e kërkuar prej tyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që ka bërë kërkësën, ka tē drejtë tē procedojë sipas ligjit në fuqi " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
6. Lajmërimi për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme rregullisht bëhet nga administratorët.
7. Asambleja e përgjithshme merr vendimë për cështjet e mëposhtme dhe është përgjegjëse për to:
  - a) Përcaktimi i politikave tregtare tē shoqërisë; ndryshimet e statutit;
  - b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve tē shoqërisë;
  - c) Emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël tē autorizuari;
  - d) Përcaktimin e shpërbllimeve për administratorët, likujduesit dhe tē ekspertëve kontabël tē autorizuari;
  - e) Mbikqyrjen e zbatimit tē politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe tē raporteve tē ecurisë së veprimit;
  - f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe tē raporteve tē ecurisë së veprimit (pas marrjes riç shqyrtim tē dokumentacionit përkatës);
  - g) Zmadhimin dhe zwogëlimin e kapitalit (pas marrjes në shqyrtim tē dokumentacionit përkatës);



A202405212125375811

- b) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- l) Cështje të tjera të parashikuara nga ligji;
8. Të gjitha vendimet të marra nga Asambleja e Përgjithshme rregistrohen ne një regjistër të vendimeve, të dhëna të cilat nuk mund të ndryshohen apo të fshihen.
9. Duhet rrugjistuar në vecantë, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- Miratimin e Pasqyrave Financiare Vjetore dhe të Raporteve të ecurisë së veprimitarës;
  - Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e lumbjeve;
  - Investime;
  - Vendime për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
10. Vendimet e parregjistruar në regjistrin e vendimeve janë automatikisht të pavlefshme.
11. Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asamblesë së përgjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.
12. Asambleja e përgjithshme vodos me shumicë të zakonshme për cështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi i pasqyrave financiare vjetore. Asambleja mund të marre vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave dhe vendimet merren me me shumë se gjysma e votive të ortakëve pjesëmarrës.
13. Asambleja e përgjithshme vodos me shumicë të kualifikuar për cështje të tilla si ndryshimet e statutit, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar, kalimi tek të tretët, zgjaja e kohës së veprimitarës së shoqërisë apo likujdimi i saj, shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera, ndarja e fitimeve si dhe edo cështje tjeter që parashikohet në ligj. Marrja e vendimevetë vlefshme bëhet vetëm nëse ortakët që zotërojn më shumë se 50% e kuotave janë të pranishme, votojnë me shkresë apo mjete elektronike. Në këtë rast vendimet merren me % e votive të ortakëve pjesëmarrës.
14. Në se asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendorë në këtë pikë, të këtij nen, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**Neni 19  
Administratori**

- Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator të cilët janë persona fizikë të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.
- Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.
- Afati i emetimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi competent mund të bëhet në edo kohë.
- Emërimi i administratorëve prodhon efekt pas regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Rëgjistrimit.
- Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblesë së përgjithshme sipas parashikimit në këtë statut.

**Neni 20  
Kompetencat e administratorëve**

- Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimitarosë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - Kujdesen përmbytjen e sakta e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimitarës dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpëra asamblesë së përgjithshme përmiratim;
  - Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimitarës dhe ekzistencen r shoqërisë;
  - Krijojnë rregjistre dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin Qëndrën Kombëtare të Rëgjistrimit;
  - Rapojojnë përpëra asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me rëndësimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecantë për veprimitarinë e shoqërisë tregtare;



A2024052121253758114

- h) Kryejnë detyra të tjera të përaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin asambleën e përgjithshme përsaparashikon ky statut ose ligji.
3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në cdo kohë me shumice të zakoshme.

**Neni 21**

**Emërimi i Parë I Administratorëve**

2. Administratori i shoqërisë për periudhën 5-vjecare

**Neni 22**

**Ekspertë Kontabël të autorizuar**

1. Në rast nevoje si dhe kur kërkohet nga ligji, kontrolli finansiar dhe aprovimi i llogarive vjetore kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar, i emëruar për dy vite financiare me mundësi rizgjedhje nga asambleja e përgjithshme me shumicë të zakonshme.
2. Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emerimi i tij, në rast se vërtetohen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

**KREU VI**

**VOTA**

**Neni 23**

**E drejta e votës**

Cdo kuotë jep të drejtën e një vote. Cdo ortak votat që ka mund ti japi vetëm në uniformitet.

**Neni 24**

**E drejta për të kaluar rezolutë**

Asambleja e përgjithshme munt të miratojë rezolutë pa plotësuar kriteret e njostimit në këtë statut apo në ligj, Që të miratoket një rezolutë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme duhet të jenë të pranishme të gjithë ortakët personalisht dhë eto votojnë atë në mënyrë të unifikuar.

**KREU VII**

**MARRËDHËNIET FINANCIARE**

**Neni 25**

**Viti Financiar**

Cdo vit financiar fillon nga 1 Janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

**Neni 26**

**Bilanci Vjetor**

1. Bilanci vjetor, inventari, raportet mbi operacionet financiare dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratorët dhe eventuaisht nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga asambleja e përgjithshme e zakonshme,
2. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhen brënda një afati prej tre muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.
3. Gjuha që përdoret në miratimin e dokumentave është gjuha shqipe.

**Neni 27**

**Dividentët**

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, asambleja e përgjithshme përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e divididentëve mbi fitimin në raport me kuatat që gjithsecili ka në shoqëri.

**Neni 28**

**Marredhenia me bankat dhe institucionet financiare**

Shoqëria ka të drejtë të hap llogari likuisuese pranë një ose më shumë bankave ose institucionet financiare dhe të kryejë veprime likujduese pranë bankave. Në këto banka ose institucionet financiare si nënshkrim i parë do të depozitohet ai i administratorit të shoqërisë, i cili duhet të nënshkruaj për të gjitha veprimet financiare në emër e për llogati të shoqërisë. Ai mund të autorizojë edhe persona të tjera brënda shoqërisë.



A2024052121253758114

Neni 29  
Marrëdhënia me organet tatuare.

Veprimitaria ekonomike e shoqërisë mbaron më 31 dhjetor të cdo viti. Administratori ose personali e caktuar prej tij janë të detyruar të paraqesin bilancin vjetor dhe deklarimin e të ardhurave dhe ti dorzoj pranë organit përkatës të tatuimeve.

KREU VIII  
NDRYSHIMI I STATUTIT TË SHOQËRISË

Neni 30  
Prishja e shoqërisë

- Shoqëria prishet me perfundimin e asfatit të përcaktuar, kur kjo vendoset nga ortakët si dhe kur janë arsyet e parashikuara në ligj.
- Shoqëria nuk prishet kur njëri prej ortakëvë falimenton, bëhet i paastë ose vdes, por vazhdon aktivitetin me ortakët e tjera që kanë mbetur si dhe me trashëgimtarin e radhës së parë të ortakut të vdekur.

Neni 31  
Likujdimi

- Shoqëria hyn në procesin e likujdimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi asambleja emëron një likuidus, i cili i paraqet asaj raportin e likujdimit dhe asfatin e nevojshëm të përfundimit të tij.
- Në fund të procesit të likujdimit asambleja vendos me vendimin e ortakëve që zotërojnë të paktën % e kuotave të kapitalit mbi bilancin përfundimtar e financiar, mbi aktin e rregullueshmërisë së punës së likuiduesit dhe për mbylljen e procesit të likujdimit.
- Pas pagimit të kreditorve dhe shlyerjes së kuotave tek kontribuesit përkatës, likuiduesi ndan kapitalet e mbeturë ndërmjet ortakëve proporcionalisht me pjesët që ato zotërojnë në kapitalin themeltar.

Neni 32  
Shndërrimi I shoqërisë

Shndërrimi I shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në lloj tjetër shoqërie mund të kryhet vetëm me miratimin unanim të ortakëve.

KREU IX

DISPOZITA TË TJERA  
Neni 33  
Mosmarrveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likujdimit midis ortakëve, ndërmjet shoqërisë dhe ortakëve, do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë.

Neni 34

Për cështjet që nuk janë parashikuar në këtë statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Ky Statut nënshkruhet nga themeluesit,

THEMELUESIT E SHOQËRISE

Rrethanat për hartimin e aktit notarial:

Personat me identitetin e mësپperm shprehën vullnetin e tyre të lirë e të plotë, për të krijuar një shoqëri tregtare, të formës shoqëri akcionare, e cila do të krijohet dhe veprojë sipas legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare, si dhe do të referohet për mbarëvajtjen e saj në Aktin e Themelimit dhe Statutit të krijuar nëpërmjet këtij akti.



A202405212125375814

Në zbatim të gjurmës "P" të pilkës 1 të nenit 62 të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për NoterInë", ku parashikohet: Kompetencat e noterit/es: I) përpilon dhe merr pjesë aktive në hartimin e akteve të shoqërisë tregtare", unë noterja marr pjesë gjatë hartimit të Aktit të Themelimit dhe të Statutit të shoqërisë.

Për sa më sipër, u hartua Statuti i shoqërisë aksionare "Fusha\_EmrilShoqates" sh.a, nga unë noterja, në prezencë të ortakëve të shoqërisë, bazuar në vullnetin e lirë e të plotë të tyre, si duc në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare. Pasi u lexua qartazi dhe u kuptua rëndësia e caktit ligjore, nënshkruhet Statuti i shoqërisë Fusha\_EmrilShoqates sh.a me adresë ne Fusha\_AdresaEShoqates dhe drejtor ekzekutiv Fusha\_DrejtorEkzekutiv, në praninë time. Unë noterja, e vërtetoj sipas ligjt.

Statuti përbëhet nga \_\_\_ ( \_\_\_ ) faqe dhe lëshohet në \_\_\_ ( \_\_\_ ) kopje origjinale me fuqi të njëjtë Juridike.

Unë Noterja, verifikova identitetin e tij/saj nëpërmjet dokumenteve të identitetit cituar më sipër dhe pasi e gjetja përmbytjen e aktit notarial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin nenit 62, pikë 1, gjermane "II", të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti notarial, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

THEMELUES/IT  
Dorjan Dogjani

NOTERE  
SANJA A. TELHALLARI

